

VENDIM
Nr. 32, datë 13.5.2014

**MBI PROBLEMET E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË ZONAT INFORMALE DHE
PËR KLIENTËT QË NUK PLOTËSOJNË KUSHTET TEKNIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7.2 të rregullores për lidhjet e reja, miratuar me vendimin nr. 22, datë 25.2.2012, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve mbi problemet e furnizimit të energjisë elektrike në zonat informale dhe për klientët që nuk plotësojnë kushtet teknike,

Konstatoi se:

- “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm ka detyrën të kryejë shërbimin e furnizimit me energji elektrike në përputhje me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore për furnizimin me energji të klientëve tarifor sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

- Po ashtu çdo veprim apo mosveprim tjetër i “CEZ Shpërndarje” që buron nga marrëdhënia e furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve tarifore (përfshirë ndërprerjet e energjisë elektrike), duhet të respektojnë legjislacionin në fuqi.

- Çdo konsumator që përdor energji elektrike duhet të faturohet sipas regjistrimeve të aparateve matës, siç përcaktuar të nenit 51 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Konsumatorët e tjerë të cilët përdorin energji elektrike të pa pajisur me matës duhet të faturohen në përputhje me nenin 52 të këtij ligji dhe vendimit të ERE-s nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Për lidhjen e konsumatorëve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, në pamundësi të një dokumentacioni pronësie, të pezullohet për një afat të pacaktuar zbatimi i pikës 3.1.6 të “Rregullores për lidhjet e reja në rrjetin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 22, datë 25.2.2012.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti